



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

URDHËR

Nr 88 datë 22/1 /2016

Për

MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT
TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 14, të ligjit nr.111/2015, date 15.10.2015, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar" dhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm,


URDHËROJ:

1. Miratimin e "Rregullores së Funkcionimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar", sipas tekstit, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Minierave dhe Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.
3. Rregullorja e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar e miratuar me Urdhrin e Ministrit nr.384, 25.11.2017 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
SHËRBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR

RREGULLORE

**PËR FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT
GJEOLGJIK SHQIPTAR (SHGJSH)**

Miratuar me Urdhër nr. 88 datë 22.2.2016

Tirane, 22/02/2016

Rregullorja ka për qëllim funksionimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas strukturës organike, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të ShGjSh-së, organet drejtuese si dhe detyrat e tyre. Rregullorja është hartuar në zbatim të nenit nr.14 të ligjit "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar".

Neni 1 Statusi Juridik

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është person juridik publik buxhetor, institucion këshillimor, teknik dhe shkencor i shtetit që me porosi të tij kryen veprimtari në fushën e Shkencave të Tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2 Selia

Selia e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar është në Tiranë në adresën: Rruga Myslim Keta.

Neni 3 Vula zyrtare dhe stema

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka vulën dhe logon e tij të miratuar nga Ministri.

Neni 4 Kapitali

Shteti, është zotëruesi i vetëm i kapitalit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe ushtron të drejtën e tij si pronar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5 Financimi

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, financohet nga Buxheti dhe nga të ardhurat për shërbime me të tretët, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore. Financimi Buxhetor Vjetor zbërthehet në Fusha Studimore e Projekte.

Neni 6 Shpenzimet

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, përbën një njësi të vetme shpenzuese, për të cilën miratohen fondet buxhetore vjetore, me të cilat mbulohet realizimi i veprimtarisë të ngarkuar me ligj dhe akte nënligjore.

Fondet buxhetore të miratuara nga Ministria në programin buxhetor vjetor, shpenzimet korente dhe investimet e ShGjSh-së, shpenzohen kundrejt projekteve, programeve, nënprogrameve (fushat zhvillimore) të brendshme dhe projekt-programeve të veçanta për secilin nënprogram, që miratohen çdo fillim viti nga Drejtori i Përgjithshëm i ShGjSh-së.

Procedurat e përgatitjes, paraqitjes, shqyrtimit, miratimit dhe kontrollit të zbatimit të programeve të financuara nga buxheti i shtetit miratohen me rregullore të veçantë të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 7 Fusha dhe objekti i veprimtarisë

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ushtron veprimtarinë e vet në përputhje me ligjin "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar", Rregullores së Funkcionimit të ShGjSh-së", të miratuar nga Ministri, si dhe "Rregullores së Funkcionimit të Brendshëm", të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ShGjSh-së.

Angazhimi i ShGjSh-së në shërbime të rëndësishme për ekonominë kombëtare, bëhet në zbatim të Programeve të Qeverisë, Ligjit për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, Ligjit "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", Ligjit për "Mbrojtjen e Mjedisit", Ligjit "Për Menaxhimin e Integruar të Ujërave", VKM-së "Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit", Ligjit "Për Urbanistikën", VKM-së "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, Ligjit "Për Emergjencat Civile", VKM-së "Për Organizimin, Funkcionimin Detyrat dhe Përgjegjësitë e Shërbimit të Emergjencave Civile".

Objekt i veprimtarisë së ShGjSh-së është:

- a. Studimet, vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet gjeologjike sistematike bazë të vendit nëpërmjet hartografimit kompleks të shkallëve të ndryshme në ndihmë të zhvillimit ekonomik, të miradministrimit të territorit, burimeve minerare, hidrokarbure, ujore, etj.
- b. Studimet, vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet gjeokimike, gjeofizike, përfshirë sizmikën e cekët (inxhinierike), elektrometrinë, magnetimetrinë, gravimetrinë, radiimetrinë, matjet e monitorimin e radonit në tokë, ujë, ajër si dhe në mjediset e brendshme, të çdo lloji e niveli.
- c. Kërkimi dhe vlerësimi i mineraleve metalore, jo metalore dhe materialeve industriale, hidrokarbureve, burimeve ujore nëntokësore, ujërave të pijshëm e industrialë, ujërave minerale, termale e gjeotermale. Kontrolli i bilancit të tyre në mënyrë të vazhdueshme.
- d. Studimet, vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet hidrogjeologjike për rivlerësimin e baseneve ujore, monitorimin e tyre dhe përcaktimin e masave për ruajtjen e rezervave ujore nëntokësore.
- e. Studimet, vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet gjeologjike komplekse për mjedisin.
- f. Studimet, vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet gjeologo-inxhinierike.
- g. Studimet, vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet agro-gjeologjike e të erozionit.
- h. Studimet, vrojtimit, shërbimet, monitorimet gjeologjike të gjithë vijës bregdetare dhe të shelfit kontinental të vendit, për dinamikën e veprimit të detit me tokën, për litologjinë e substratit dhe pasuritë e ndryshme detare e nëndetare.
- i. Studimet, vrojtimit, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet e thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë.
- j. Përgjithësimet, vrojtimit, monitorime e dokumentime të gjithë punimeve inxhinierike që kanë të bëjnë me gërmimin e tokës.
- k. Punimet topografike të shkallëve të ndryshme dhe matjet gjeodezike.
- l. Krijimi i bazës së të dhënave gjeologjike, të mineraleve të dobishme, gjeologo- inxhinierike, hidrogjeologjike, gjeo-mjedisore etj., vënia në dispozicion e këtyre të dhënave organeve të

- pushtetit qendror e lokal dhe subjekteve të tjera të interesuara, përgatitja, publikimi dhe komercializimi i informacionit gjeologjik, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.
- m. Promovimi i perspektivës së mineraleve të dobishme.
 - n. Monitorimi dhe vlerësimi i lejeve minerare të kërkim-zbulimit.
 - o. Kryerja e shërbimeve të ndryshme për të tretët.
 - p. Kryerja e studimeve për emergjencat civile, gjeologjike, gjeologo-inxhinierike e hidrogeologjike.
 - q. Kryerja e oponentave për të gjitha llojet e studimeve në fushën Gjeoshkencave.

Neni 8 Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm

Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm, ashtu si i gjithë stafi tjetër i ShGjSh-së emërohen në detyrë dhe lirohen nga detyra sipas ligjit "Për Nëpunësin Civil".

Neni 9 Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm

- a. Drejton dhe është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
- b. Shqyrton dhe miraton propozimet për strategjinë, programet afatgjata, afatmesme e vjetore të zhvillimit si dhe drejtimet e veprimtarisë së ShGjSh-së, i cili i dërgon në Ministrinë përgjegjëse për miratim.
- c. Miraton programin vjetor zhvillimor të institucionit dhe e dërgon atë në Ministrinë përgjegjëse.
- d. Ka të gjithë kompetencat dhe përgjegjësitë që të veprojnë për të organizuar e drejtuar ShGjSh-në në përputhje me Financimet, strukturën organizative, veprimtarinë dhe strategjinë e programit zhvillimor.
- e. Drejton dhe është përgjegjës për zbatimin e urdhrave të Ministrit.
- f. Miraton dhe firmos Financimin të Fushave Studimore sipas objektivave, afateve, personave përgjegjës dhe vleftën e financimit të detajuar sipas zërave që kërkohen.
- g. Organizon kontrolle dhe kërkon Raportime me gojë e me shkrim nga çdo punonjës, për zbatimin e programeve zhvillimore.
- h. Shqyrton strukturën organizative dhe sistemin e pagave të ShGjSh-së dhe ia paraqet Ministrit.
- i. Përfaqëson Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në marrëdhëniet ndërkombëtare.
- j. Përfaqëson ShGjSh-në në marrëdhënie me të tretët, nënshkruan kontrata të ndryshme në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- k. Miraton tarifa për të tretët për shërbime që nuk përfshihen në tarifën e miratuar nga Ministri i vartësisë dhe Ministri i Financave sipas aktit përkatës. Këto tarifa do të miratohen me kusht që me të ardhurat të mbulohen shpenzimet, TVSH-ja dhe të sigurohet Fitim për Institucionin, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- l. Miraton listë-organikën e pagat e punonjësve të çdo Drejtorie të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, sipas strukturës së miratuar.
- m. Emëron, liron dhe shkarkon nga detyra me arsye të motivuar, sipas "Kodit të Punës", punonjësit e ShGjSh-së, që nuk janë pjesë e ligjit "Për Nëpunësin Civil".
- n. I propozon Ministrit përbërjen e Këshillit Teknik Shkencor dhe rregulloren funksionimit të tij.

- o. Drejton Këshillin Teknik Shkencor të Sh.Gj.Sh-së.
- p. Urdhëron ndërprerjen e financimit të projekteve kur rezultatet e fituara nuk justifikojnë vazhdimin e mëtejshëm.
- q. Konform legjislacionit, urdhëron çdo blerje e shërbim për Institucionin.
- r. Konform legjislacionit, kryen procedura për transferimet kapitale të mjeteve themelore, shitjet (privatizimet), nxjerrjen jashtë përdorimit dhe dhënien me qira.
- s. Autorizon konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi shitjen ose përdorimin e të dhënave që disponon Arkivi Qendror Teknik i ShGjSh-së.
- t. Miraton pjesëmarrjen e punonjësve të ShGjSh-së në veprimtari kombëtare dhe ndërkombëtare.
- u. Kërkon llogari për zbatimin e detyrave dhe urdhrave të lëshuara prej tij ndaj çdo punonjësi të ShGjSh-së dhe jep masa administrative e disiplinore konform legjislacionit në fuqi, për moszbatimin e tyre.
- v. Miraton Rregullore të funksionimit të brendshëm të Drejtorive sipas strukturës dhe Procedurat e përgatitjes, paraqitjes, shqyrtimit e kontrollit të zbatimit të projekteve që financohen nga Buxheti i Shtetit dhe të tretët.

Neni 10

Kompetencat e Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm

- a. Drejton dhe përgjigjet për gjithë veprimtarinë e ShGjSh-së në mungesë të Drejtorit të Përgjithshëm.
- b. Drejton dhe përgjigjet për Drejtorinë e Programim-Zhvillimit, Arkivin Qendror Teknik, fizik dhe dixhital sipas rregulloreve përkatëse në fuqi.
- c. Koordinon dhe ndjek punën e gjithë Drejtorive për hartimin e programeve, projekteve, studimeve, relacioneve dhe raporteve të ShGjSh-së, e të çdo aktiviteti me të tretët.
- d. Ndjek zbatimin e procedurave të lidhjes së kontratave e zbatimit të tyre dhe plotësimin e kërkesave për furnizimin materialo-teknik.
- e. Ndjek dhe organizon punën për përmirësimin e kushteve të punës të punonjësve, mbrojtjen në punë, sigurimin teknik, mbrojtjen nga zjarri, etj.
- f. Ndjek dhe përgjigjet për publikimin e veprimtarisë së ShGjSh-së, brenda dhe jashtë vendit, ndjek plotësimin mirëmbajtjen e faqes së Internetit të Institucionit.
- g. Ndjek probleme të kualifikimit e specializimit të punonjësve të ShGjSh-së.
- h. Kujdeset për zbatimin e teknologjisë dhe informacionin në Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
- i. Konsulton, propozon dhe bashkëpunon punën me gjithë Drejtoritë për hartimin e programeve ekonomike-financiare dhe detajimin e buxhetit.
- j. Ndjek dhe propozon masa për realizimin e Programit Zhvillimor të ShGjSh-së.
- k. Përgjigjet për çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 11

Struktura dhe Organika

Struktura organizative dhe Organika e ShGjSh-së, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe është pjesë përbërëse e Rregullores.

Neni 12

Struktura dhe niveli i pagave

Niveli i pagave në ShGjSh miratohet me VKM sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13 **Këshilli Teknik Shkencor**

Këshilli Teknik Shkencor është strukturë vendimmarrëse, tekniko-shkencorë e ShGjSh-së, përbërja dhe rregullorja e funksionimit të tij miratohet nga Ministri, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 14 **Detyrat e Këshillit Teknik Shkencor**

- a. Shqyrton dhe merr vendime për strategjinë, programet afatgjata dhe afatmesme, programet vjetore të zhvillimit të ShGjSh-së dhe pasi firmosen nga Drejtori i Përgjithshëm, i paraqet për miratim tek Ministri.
- b. Shqyrton dhe merr vendime për vlerësimin e rezultateve të arritura nga projekt/programet e realizuara në studimet e raportet studimore .
- c. Shqyrton dhe merr vendime për problemet e lejeve minerare të kërkim-zbulimit.
- d. Shqyrton dhe merr vendime për rregulloren e funksionimit të drejtorive në përbërje të strukturës së ShGjSh-së.
- e. Këshilli Teknik Shkencor kryen funksionin e Grupit për Menaxhimi Strategjik (GMS).
- f. Veprimtaria e Këshillit Teknik Shkencor bazohet në rregulloren e miratuar nga Ministri me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 15 **Drejtoritë e ShGjSh-së**

- a. ShGjSh-ja, organizohet mbi bazën e Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive të Shërbimit, të cilat mbulojnë fusha e veprimtari të veçanta.
- b. Në përbërje të ShGjSh-së e në varësi të drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm të ShGjSh-së janë Drejtoritë si më poshtë:

I. Drejtoria e Përgjithshme

1. Drejtoria e Programim-Zhvillimit
2. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve

II. Drejtoritë Aplikative

1. Drejtoria e Gjeoinformatizimit
2. Drejtoria e Gjeologjisë
3. Drejtoria e Burimeve Minerale
4. Drejtoria e Hidrokarbureve
5. Drejtoria e Hidrogjeologjisë
6. Drejtori e Gjeologjisë Detare

7. Drejtoria e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë

8. Drejtoria e Laboratorit të Analizave Kimike

Neni 16

Detyrat e Drejtorisë së Programim-Zhvillimit.

Misioni i Drejtorisë së Programim-Zhvillimit është programimi, menaxhimi dhe vlerësimi i produkteve të realizuar nga drejtoritë e shërbimit në kuadër të programit zhvillimor të financuar nga buxheti i shtetit dhe shërbimet me të tretët. Kjo Drejtori ndjek detyrat si më poshtë:

- a. Zbërthen, programon detyrat dhe harton matricën bazë me objektivat kryesore, sipas fushave zhvillimore (nën/programeve) . Me miratim nga Drejtori i Përgjithshëm i dërgon në drejtoritë e shërbimit të ShGjSh-së.
- b. Pranon nga çdo drejtori Shërbimi projekt-programet, bën grupimin e projekt- programeve të ngjashme, koordinon angazhimin në projekt-programe të përbashkëta të specialistëve nga drejtoritë e ndryshme të ShGjSh-së, verifikon përlllogaritjet e kostot e tyre dhe i paraqet tek Drejtori i Përgjithshëm bashkë me vlerësimin për programimin e financimin ose jo të tyre.
- c. Me miratimin e projekt programit vjetor, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, përgatit treguesit e përgjithshëm të punës e financiar sipas projekt-programeve të veçanta dhe programin e përgjithshëm vjetor të ShGjSh-së. (Projekt/Buxheti Vjetor).
- d. Me miratimin e buxhetit dhe numrit të punonjësve për vitin pasardhës, bazuar në projekt-programet e miratuara sipas fushave zhvillimore, strukturën organizative, përparësive që përcakton programi vjetor i Ministrisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, harton dhe paraqet për miratim tek Drejtori i përgjithshëm i ShGjSh-së programin zhvillimor vjetor me tematikat e projekt-programeve të veçanta, afatin e realizimit, pjesëmarrjen e specialistëve në drejtimin dhe realizimin e tyre, planin e financimit të secilit projekt-program të veçantë sipas fushave zhvillimore dhe drejtorive aplikative përgjegjëse për realizimin e projekteve.
- e. Me miratimin e programit zhvillimor vjetor nga Drejtori i Përgjithshëm u dërgon drejtorive të shërbimit për hartimin e plotë të secilit program të veçantë, sipas modelit të miratuar.
- f. Programon ekspertizat, merr miratimin tek Drejtori i Përgjithshëm dhe ndjek ekspertimin.
- g. Shqyrton projektet, ekspertizat, jep mendimin për projektin në gjithë zërat e tij dhe përgatit vendimin miratues për Këshillin Teknik Shkencor dhe për Drejtorin e Përgjithshëm. Arkivon projektet.
- h. Sipas një plani të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, kontrollon në proces ecurinë e projekteve.
- i. Pranon nga drejtoritë aplikative, raportet studimore, bën kontrollin e tyre, sipas ekspertizave dhe i paraqet për miratim në Këshillin Teknik Shkencor dhe tek Drejtori i Përgjithshëm.
- j. Shqyrton raportet studimore, ekspertizat e tyre, përpilon vendimin miratues të studimit dhe e paraqet për shqyrtim e miratim në Këshillin Shkencor dhe tek Drejtori i Përgjithshëm.
- k. Ndjek plotësimin e raporteve studimor dhe arkivimin e tij në Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë.
- l. Programon në bazë të kërkesave veprimtarinë për problemet e emergjencave civile dhe kryen studime për emergjencat civile (rrëshqitje, subsidenca, shembje terreni, etj.).
- m. Programon në bazë të kërkesave veprimtarinë dhe aktivitetet me të tretët.

- n. Administron sipas ligjit për ShGjSh-së dhe ligjit për arkivat, Arkivin Qendror Teknik të Gjeologjisë. Plotëson kërkesat për arkivin nga specialistet e ShGjSh-së dhe nga të tretë.
- o. Përpilon informacionet 3 ose 4-mujore të realizimit të projekteve për Ministrinë.
- p. Programon dhe koordinon, sipas kërkesave të drejtorive të shërbimit, angazhimin e ShGjSh-së, ne projekte dypalëshe apo shumë palëshe, i paraqet për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm.
- q. Koordinon punën me Laboratorin, Gjeoinformacionin dhe Drejtoritë tjera aplikative për analizat dhe përpunimin dixhital të dokumentacionit gjeologjik të projekteve, studimeve, raporteve.
- r. Publikon rezultatet e arritura nga ShGjSh-ja. Promovon produktet e ShGjSh-së, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- s. Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera, përgatit materialet për faqen e internetit.
- t. Ndjek në koordinim me Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, shpenzimet për projektet, propozon ndryshime të tyre.
- u. Angazhohet në realizimin direkt për projekte të veçanta.
- v. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 17

Detyrat e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve

- a. Administron veprimtarinë e brendshme ekonomiko-financiare të ShGjSh-së konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- b. Mban përgjegjësi të plotë për zbatimin e rregullave të menaxhimit të Buxhetit, për organizimin e drejtimit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të Institucionit.
- c. Përgjigjet dhe menaxhon Prokurimet, lidhjen e kontratave, zbatimin e tyre.
- d. Menaxhon shërbimet ndihmëse dhe administrative.
- e. Përgjigjet për administrimin e Burimeve Njerëzore, sipas ligjeve në fuqi.
- f. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Programim Zhvillimit përpunon dhe paraqet në kohë Projekt-Programin e Financimit për vitin pasardhës.
- g. Me miratimin e Financimit Buxhetor (të vlerës së financimit shpenzime korente dhe investime) në bashkëpunim me Drejtorinë e Programim Zhvillimit përgatit preventivat për çdo projekt.
- h. Bashkëpunon me Drejtoritë e Ministrisë që mbulon aktivitetin, për problemet ekonomiko-financiare të Institucionit.
- i. Siglon çdo material për veprimtarinë ekonomiko-financiare që del nga kjo Drejtori dhe Drejtoritë e tjera që dërgohet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm.
- j. Përgjigjet në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për administrimin e gjithë pasurisë që është në inventarin e ShGjSh-së.
- k. Përgjigjet për sigurimin e kushteve të punës, sigurimin teknik, mbrojtjen nga zjarri etj.
- l. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 18

Detyrat e Drejtorisë së Gjeoinformatizimit

- a. Aplikon sistemin GIS për aktivitetin që kryen Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, prodhon harta dhe dokumentacion dixhital.

- b. Krijon, plotëson dhe azhurnon në vazhdimësi bazën e të dhënave për të gjitha fushat e veprimtarisë së ShGjSh-së.
- c. Bën modelime gjeologjike, tektonike të vendburimeve të resurseve minerale, ujërave nëntokësore, të hidrokarbureve dhe gjeologo-inxhinierike, etj.
- d. Bën përpunimin informatike të të dhënave të studimeve e projekteve, Arkivit Qendror Teknik të Gjeologjisë, si dhe kryen përpunimin e të dhënave sipas kërkesave të Ministrisë.
- e. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Programim Zhvillimit dhe drejtoritë e tjera, plotëson dhe formaton faqen e internetit të institucionit.
- f. Përgjigjet për zbatimin e rregullores të Arkivit Dixhital të ShGjSh-së.
- g. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 19

Detyrat e Drejtorisë së Gjeologjisë

- a. Bën hartografime komplekse gjeologjike, regjionale dhe lokale në shkallë e për qëllime të ndryshme për të gjithë vendin dhe zhvillimin e qëndrueshëm e të harmonizuar të territorit.
- b. Kryen hartografime e korrelime të depozitimeve të Kuarternarit, vlerëson lëvizjet tektonike e neoteknike dhe Gjeomonumentet në gjithë territorin e vendit.
- c. Kryen monitorimin e gjeomjedisit, ndotjeve gjeokimike në mjedise urbane dhe industriale, kryen zonimet gjeomjedisore.
- d. Vlerëson sektorët me kushte të favorshme gjeologjike konform kritereve të Euro- Kodit për vend-depozitat e mbetjeve urbane e industriale etj.
- e. Kryen studime e vrojtme në bashkëpunim me vendet ndërkufitare të rajonit për problemet gjeologjike, tektonike, stratigrafike, gjeomjedisore, etj.
- f. Punon në vazhdimësi për kompletimin e muzeumit të Shërbimit Gjeologjik.
- g. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 20

Detyrat e Drejtorisë së Burimeve Minerale

- a. Bën përgjithësimet metalogjenike prognoze në nivel krahinor dhe lokal.
- b. Bën studime tematike për kërkim-zbulimin e mëtejshëm të resurseve minerale të vendit.
- c. Kryen rivlerësim të resurseve minerale metalore e jometalore me synim zgjerimin e perspektives, standardizimin e resurseve minerale sipas kërkesave të kohës, si dhe studime gjeologo-ekonomike që ndikojnë në futjen në qarkullim të shpejtë të lëndëve të para e për tërheqjen e investitorëve.
- d. Punon për plotësimin e bazës së të dhënave për të gjithë vendburimet.
- e. Verifikon vërtetësinë e sasisë dhe cilësisë së rezervave.
- f. Vlerëson ndikimet minerale, hidrogeologjike etj., në mjedis si rezultat i punimeve të kërkim-zbulimit e shfrytëzimit.
- g. Vlerëson dokumentacionin e veprimtarinë e kompanive private për marrjen e lejeve të kërkimit-zbulimit dhe kryen monitorimin e verifikimin në vazhdimësi të aktivitetit tyre.
- h. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 21
Detyrat e Drejtorisë së Hidrokarbureve

- a. Bën hartografime gjeologjike e komplekse në shkallë të ndryshme, për problemet e hidrokarbureve dhe zhvillimit të qëndrueshëm e të harmonizuar në shkallë vendi.
- b. Bën përgjithësime prognoze në nivel krahinor dhe lokal për lëndët hidrokarbure.
- c. Kryen rivlerësim të burimeve hidrokarbure me synim zgjerimin e perspektivës, si dhe studime gjeologo-ekonomike që ndikojnë në futjen në qarkullim të shpejtë të tyre, e për tërheqjen e investitorëve.
- d. Punon për plotësimin e bazës së të dhënave për të gjitha vendburimet hidrokarbure të vendit.
- e. Verifikon vërtetësinë e sasisë dhe cilësisë së rezervave.
- f. Vlerëson ndikimet gjeologjike, hidrogeologjike etj., në mjedis si rezultat i punimeve të kërkim-zbulimit e shfrytëzimit të hidrokarbureve.
- g. Bashkëpunon me Drejtorinë e Gjeologjisë Detare për studimin e mundësinë e gjetjes së strukturave gjeologjike perspektive për hidrokarbure në shelfin kontinental të vendit.
- h. Bashkëpunon dhe azhuron të dhënat e fituara nga veprimtaria e kërkim-zbulimit për hidrokarbure me kompanitë publike e private vendase e të huaja.
- i. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 22
Detyrat e Drejtorisë së Hidrogeologjisë

- a. Vlerëson dhe monitoron burimet ujore, rezervat e ujërave nëntokësore në basenet kryesore ujëmbjatese me përparësi, zonat urbane dhe turistike.
- b. Përcakton mundësitë e reja për furnizimin me ujë, jep rekomandime për shfrytëzimin racional të rezervave ujore.
- c. Bën hartografime dhe përgjithësime në nivel krahinor e lokal, përpilon projekte për furnizimin me ujë.
- d. Bën oponenta të studimeve hidrogeologjike të kryera nga persona apo kompani private.
- e. Kryen monitorimin kompleks të të gjithë rrjetit lumor të vendit për vlerësimin e qëndrueshmërisë së shtretërve e anëve të lumenjve dhe erozionit, si dhe jep rekomandimet përkatëse.
- f. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 23
Detyrat e Drejtorisë së Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë

- a. Bën studime, hartografime e shërbime gjeologo-inxhinierik, në nivel krahinor dhe lokal, për zonat urbane e rurale, stabilitetin e truallit, vlerësimin e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e infrastrukturës.
- b. Monitorime gjeologo-inxhinierike në sektorët me intensitet të fenomeneve gjeodinamike.
- c. Bën vlerësime të rreziqeve gjeologjike. propozon masa për zbutjen dhe mënjanimin e tyre.
- d. Bën studime e shërbime gjeofizike të llojeve e shkallëve të ndryshme.
- e. Kryen studime për emergjencat civile (rrëshqitje, subsidenca, shembje terreni, etj.).
- f. Kryen analiza për vetitë fiziko- mekanike për studimet e vrojtimit gjeologo-inxhinierike.
- g. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 24
Detyrat e Drejtorisë së Gjeologjisë Detare

- a. Kryen studime dhe ndërton hartat e Gjeologjisë Detare në shkallë të ndryshme.
- b. Studion përbërjen litologjike të substratit, ndryshimet batimetrike dhe morfologjinë e shtratit të detit, ishujt, etj.
- c. Identifikon pasuritë natyrore në zonën detare dhe pranbregdetare.
- d. Studion "ekosistemet e varura" pra lidhjet midis deltave të lumenjve, ujërave sipërfaqësore, nëntokësore, lagunave dhe deteve.
- e. Jep të dhëna gjeologjike, në studimet për ndërtimet e porteve, moleve dhe veprave të tjera inxhinierike në bregdet.
- f. Monitoron vijën bregdetare dhe shkallën e erozion-akumulimit.
- g. Bashkëpunon në kërkimet Arkeologjike e të biodiversitetit detar, kryhen studimin e ekosistemeve koralore, shpellave karstike nënujore dhe plazheve.
- h. Në bashkëpunim me drejtorinë e Hidrogjeologjisë identifikon dhe monitoron burimet nëndetare të ujërave të ëmbla.
- i. Krijon database kombëtare për studimet dhe të dhënat detare.
- j. Bashkëpunon në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e studimeve të thelluara detare mbi gjeologjinë e substratit, riskun sizmogjenik, aspekte tektonike të bazamentit detar, lidhjen e dinamikës bregdetare me aktivitetin tektonik, etj.
- k. Jep të dhëna mbi mundësinë e pranisë së strukturave naftë-gaz mbajtëse në det (shelfin kontinental).
- l. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 25
Detyrat e Drejtorisë së Laboratorit të Analizave Kimike

- a. Kryen analiza kimike për mineralet, shkëmbinjte, lëndë të para dhe ujëra për nevojat e studimeve të ShGjSh-së dhe për të tretët.
- b. Kryen punime studimore-tematike për qëllimet e veprimtarisë së tij analitike, si dhe shërben si Laborator Arbitrazhi.
- c. Bën përpunimin e provave për analiza kimike dhe përcaktime petrografike, paleontologjike e mineralogjike, etj.
- d. Zbaton detyra të tjera që jep Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 26
Planifikimi dhe Buxheti

Planifikimi i treguesve të Financimit Buxhetor dhe zbatimi i tyre bëhet në përputhje me Ligjin "Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore ne fuqi.

Për gjithë veprimtarinë e ShGjSh-së përgatitet programi i financimit, i zbërthyer në Fusha Studimore dhe i dërgohet Ministrisë që mbulon aktivitetin.

Neni 27
Kontabiliteti

Veprimtaria ekonomiko-financiare pasqyrohet konform Ligjit “Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 28
Burimet Financiare

Fondet e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar do të krijohen nga:

1. Financimet Buxhetore për shpenzime korente dhe investime.
2. Shërbime për të tretët me pagesë.
3. Interesa bankare
4. Projekte me financim të huaj.
5. Burime të tjera të ligjshme.

Neni 29
Fondet Monetare

Të gjithë të ardhurat nga të tretët të krijuara dhe që përdoren në zbatim të Ligjit “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh)”, janë të mbartshme nga njëri vit në tjetrin, me përjashtim të fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit, të cilat mbyllen brenda vitit kalendarik.

Neni 30
Marrëdhëniet e Punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës me ndryshimet përkatëse dhe ligjin “Për Nëpunësin Civil”.

Neni 31
Rregullat Etike

Shërbimi gjeologjik zbaton rregullat e etikës-në punë, të miratuara në Ligjin “Për etikën në administratën publike”.

Neni 32
Masat Disiplinore

- a. Mosrespektimi i Rregullores së Brendshme të ShGjSh-së, ngarkon me përgjegjësi dhe përbën shkak për marrjen e masave disiplinore të përcaktuara në Kodin e Punës, Ligji “Për Nëpunësin Civil” dhe në Rregulloren e Funkcionimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:
 - I. Vërejtje
 - II. Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj.
 - III. Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.
 - IV. Largim nga shërbimi civil.

- b. Masat disiplinore mund të merren edhe pa i respektuar radhët e mësipërme sipas dëmit ose shkeljes që shkaktohet rast pas rasti.
- c. Masën disiplinore sipas shkronjës “a/I” për nëpunësin civil e jep eprori direkt, ndërsa për shkronjat “a/II”, “a/III” dhe “a/IV”, janë në kompetencën e komisionit disiplinor.
- d. Për punonjësit që nuk kanë statusin e nëpunësit civil, masat disiplinore jepen në bazë të “Kodit të Punës”, masën disiplinore për këtë kategori punonjësish e jep Drejtori i Përgjithshëm.
- e. Masa disiplinore që u jepen punonjësve të ShGjSh-së nga Drejtori i Përgjithshëm me motivin përkatës, i dorëzohet zyrtarisht të punësuarit.

Neni 33
Administrimi i Informacionit

Administrimi, ruajtja e klasifikimi i dokumentacionit dhe informacionit bëhet sipas legjislacionit në fuqi, metodologjisë së përpunimit të dokumentacionit dhe ruajtjes së tij.

Neni 34
Miratimi i Rregullores

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe bëhet e detyrueshme për zbatim.
2. Rregullorja e Funkcionimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, e miratuar me Urdhrin e Ministrit, Nr.384, datë 25.11.2014, shfuqizohet.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

